



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBERIMIT

**RAPORT V.N.M
PROJEKT – ZBATIM**

OBJEKTI: “ RRJETI UJITES ME PUS”

2024

B.O.E "HTS COMPANY" sh.p.k & "MAGNA CHARTA" sh.p.k

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE	2
2.	STRUKTURA E RAPORTIT TE VNM	2
3.	PERMBLEDHJE E PROJEKTIT DHE KONTEKSTI.....	3
3.1	Pershkrim i kuadrit ligjor dhe institucional	3
3.2	Kuadri ligjor vendor dhe nderkombetar	4
3.3	Kuadri Ligjor European.....	5
4.	PERSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUES	6
4.1	Terreni, peisazhi dhe trashegimia kulturore.....	6
4.2	Karakteristikat klimatike te Tiranes.....	6
4.2.1	Temperatura e ajrit	7
4.2.2	Mjegulla	8
4.2.3	Reshjet atmosferike.....	9
4.2.4	Bora.....	10
4.2.5	Lagështia e ajrit	11
4.2.6	Era.....	11
4.2.7	Stuhitë.....	12
4.2.8	Llogaritjet Hidrologjike	13
5.	CILËSIA E AJRIT DHE ZHURMAT	15
5.1	Cilësia e ajrit.....	15
5.2	Ndotja akustike.....	15
5.3	Rrjeti ujqor	15
5.4	Biodiversiteti	15
5.5	Flora dhe fauna.....	16
5.6	Përdorimi i biodiversitetit	16
5.7	Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike	16
6.	TË DHËNA MBI IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË HAPJES DHE SHFRYTËZIMIT TË OBJEKTIT	16
6.1	Ndikimet në florë dhe faunë.....	16
6.2	Pluhurat gjatë procesit të punës	17

6.3	Ndikim në shëndetin e njerëzve që punojnë në objekt dhe të banorëve për rreth.....	17
6.4	Rreziqet e aksidenteve	18
6.5	KUADRI LIGJOR I POLITIKAVE, PLANET.....	19
7.	MATRICAT E NDIKIMEVE NË MJEDIS	20
7.1	Ndryshimet në popullsi	20
7.2	Ndikimet e dukëshme të projektit.....	20
7.3	Humbje e dëmtim habitati, specie bimore dhe tipareve gjeologjike	22
7.4	Ndikimet fizike	23
7.5	Ndikimet e emetimeve kimike dhe të depozitimeve	24
7.6	Ndikimet në përdorimin e tokës	24
7.7	Ndikimet në modelin drenazhues, tipareve hidrografike etj	25
7.8	Niveli dhe përqëndrimi i emetimeve kimike etj	26
7.9	Ndikimet nga projekte të tjera	27
7.10	Ndikimet shoqëruese të projektit	27
8.	Masat për eliminimin ose zbutjen e ndikimeve në mjedis.....	28
9.	Planet e monitorimit.....	29
9.1	Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	29
10.	PËRFUNDIMET KRYESORE	30

1. HYRJE

Ky raport paraprak i vleresimit të ndikimit në mjedis ka për qëllim të përshkruajë, identifikojë dhe vlerësojë efektet e mundshme domethënëse të zbatimit të kerkuar për zhvillimin e projektit në teresi me elementet e vete përberës të planifikuar konform standarteve të projektimit. Vleresimi i Ndikimit Mjedisor identifikon, përshkruan dhe vlerëson efektet direkte të projektit tek: njerezit, flora dhe fauna, ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klima, terrenin dhe ndertimi tij dhe nderveprimin e këtyre faktoreve me trashëgimie kulturore, sociale dhe mjedisore. Kjo temë është bazuar në parimet e veprimeve të parandalimit, dhe si e tillë politika më e mirë konsiston në menjanimin e ndotjes dhe problemeve të tjera që janë ngritur, me të drejte dhe që në fillim, më mirë se sa të luftohen efektet e tyre në rrjedhim.

2. STRUKTURA E RAPORTIT TË VNM

Në studimin Mjedisor për ndertimin e këtij projekti janë mbajtur parasysh elementet kryesore strategjike të mbrojtjes së mjedisit, të renditura si më poshtë:

- Parandalimi dhe ulja e ndotjes se ujit, ajrit, tokes dhe ndotjeve te tjera te cdo lloji
- Ruajtja e shumellojshmerise biologjike sipas bazes natyrore, biogeografike te vendit
- Perdorimi racional i burimeve natyrore e minerare dhe shmangia e mbishfrytezimit te tyre
- Riaftesimi ekologjik i zonave te demtuara dhe te ndotura nga veprimtaria e njeriut dhe dukurite natyrore shkaterruese

- Ruajtja e ekuilibrit ekologjik dhe permiresimi i cilesise se jetes

Studimi ka marre parasysh mbrojtjen e mundshme maksimale te biodiversitetit, parandalimin e problemeve te mundshme mjedisore ne te ardhmen. Elementet baze te metodologjise se perdorur e trajtojne zhvillimin e kesaj zone si nje proces te vazhdueshem dhe adaptiv te administrimit te burimeve. Ne kete drejtim, ka rendesi kuptimi i plote i marredhenieve midis vleresimit te sakte te vleres se pasurive natyrore, perdorimit efektiv te tyre dhe ndikimit te ndersjellte midis zhvillimit ekonomik te vendit dhe ruajtjes se mbrojtjes se mjedisit.

Shprehja e marredhenieve te mesiperme ne terma fizike e mjedisore, si dhe ne terma ekonomike, ndihmon ne planifikimin, formulimin e politikave, zbatimin dhe kryerjen e vleresimit te drejte te ndikimit ne mjedis te objektive te planifikuara per ndertimin ne zonen ne studim.

Konkretisht studimi i VNM-se per problemin ne studim ka marre parasysh:

a) Ruajtjen maksimale te mundshme te mjedisit, e cila realizohet nepermjet:

- Sugjerimit te perzgjedhjes se alternativave me me pak ndikime negative ne mjedis,
- Perdorimit te burimeve energjitike me efekt minimal ne mjedis.

b) Zhvillimin e qendrueshem te ekonomise se vendit, e cila realizohet nepermjet:

- Reduktimin e ndotjes se ajrit nga djegia e gazrave te makinave dhe ngritja e pluhurave, nepermjet permiresimit te qarkullimit
- Reduktimi i metejsheem i ndotjes se ajrit me ane te vendosjes se elementeve te gjelberimit (90 peme, 71 shkurre dhe 985 m2 tapet bari)
- Menaxhimi efikas i mbetjeve urbane me ane te instalimit te koshave te mbeturinave

3. PERMBLEDHJE E PROJEKTIT DHE KONTEKSTI

Projekti ka per qellim te rehabilitoje kete hapesire te gjelber te perdorur nga banoret e Tiranës, por qe aktualisht ndodhet ne gjendje te pakenaqshme.

Projekti konsiston ne punimet e meposhtme:

- Punime per hapje pusi
- Punime ujitjen

3.1 Pershkrim i kuadrit ligjor dhe institucional Metodologjia e hartimit te VNM

Hartimi i ketij raporti VNM eshte bere ne perputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 8 te ketij ligji ,percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis ,sipas shtojces II (pika 10) veprimtaria e projekteve te infrastruktures, nenpika b). Projektet e zhvillimit urban i nenshtrohen Procedures Paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis; Gjithashtu hartimi i ketij raporti fillestar te procedures se paraprake te vleresimit te ndikimit ne mjedis eshte bere ne perputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, i cili është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin" Metodologjia e hartimit te VNM eshte hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor te shprehura ne Udhezimin Nr.3, datë 19.11.2009 "Per Metodologjine e Vleresimit te Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis. Vleresimi i ndikimeve

ne mjedis nga aktiviteti ne zonen e projektit merr ne konsiderate se si keto procese gjate zbatimit te projektit ndikojne ne gjendjen ekzistuese te mjedisit te zones dhe me vone. Ndikimet kumulative qe mund te ndodhin mund te shfaqen menjehere kur ndodh nje nderhyrje ne mjedis apo shfaqen ne menyre indirekte dhe ato mund te shfaqin shkalle te ndryshme rendesie. Keto ndikime mund te jene te ndryshme ne kohe zgjatjen e ndikimit (Afatshkurter, Afatmesatar dhe Afatgjate ne kohe) dhe te ndryshme ne karakterin e tyre (ndikim i perkohshem dhe i perhershem).

Vlersimi i ndikimeve ne mjedis te shkaktuara nga proceset e permendura me lart jane percaktuar per pritesit ne mjedis te ketyreve ndikimeve.

- Ekosistemetet natyrore, fauna dhe flora
- Toka dhe nentoka
- Hidrologjia ne mjedis (ujrat tokesore dhe ata nentokesore)
- Cilesia e ajrit
- Klima
- Peisazhi

Shendeti publik dhe cilesia e jetes

- Pronesia (ndertimet e ndryshme dhe tokat bujqesore)
- Trashegimnia kulturore, duke permbajtur ndertimet arkeologjike dhe ato tradicionale

Gjate plotësimit të kërkesave hartuesit e ketij raporti grumbulluan informacionin e domosdoshëm, që përfshin:

- a) kërkesat e përdorimit të tokës dhe mënyrat e përdorimit aktual të saj nga zbatimi i projektit;
- b) ndërtimin e objekteve dhe instalimet e pajisjeve teknologjike që do të realizohen;
- c) proceset teknologjike, lëndët e para që do të përdoren, përfshirë edhe energjinë elektrike dhe produktin përfundimtar të procesit;
- d) shkarkimet në mjedis, si dhe mundësisht sasinë respektive të tyre;
- e) llojin e mbetjeve përfundimtare që do të prodhohen nga veprimtaria, si dhe sasinë e tyre;
- f) gjendjen aktuale të mjedisit ku do ushtrohet veprimtaria, si dhe karakteristikat e veçanta të tij, përfshi edhe statusin ligjor të zonës ku synon të ushtrohet veprimtaria;
- h) gjendja e infrastrukturës rrugore, elektrike, kanalizimet e ujërave, si dhe nevoja për infrastrukturë të re të projektit.

Hartimi i ketij raporti VNM eshte bere ne perputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis " ku sipas nenit 8 te ketij ligji, percaktohen edhe projektet qe i nenshtrohen procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis , sipas shtojces II i nenshtrohen Procedures paraprake te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

3.2 Kuadri ligjor vendor dhe nderkombetar

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte procesi qe kryhet per vleresimin e pergjithshem te ndikimeve te rendesishme negative, te drejtperdrejta ose jo, ne mjedis, nga projekti i propozuar. Per hatimin e ketij raporti mbeshtetemi ne legjislaionin shqipetar, nje kuader legjislativ dhe rregullues ne perputhje me standardet e BE-se eshte ne vazhdimesi.

Ne vijim te raportit do te njihemi me ligjet baze te cilat detyrojne me forcen ligjore mbrojtjen e mjedisit. Subjeti zhvillues eshte ne zbatim te hapave ligjore.

Ligje

Ligji Nr. 10431, date 09.06.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" i ndyshuar

Ligji Nr. 128/2020 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 10440, date 7.7.2011,

“Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ”, te ndryshuar

Ligji Nr. 81/2017 “Per zonat e mbrojtura”

Ligji Nr.10 463, date 22.9.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”

Ligji Nr. 111/2012 “Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore”

Ligji Nr.9587, date 20.7.2006” Per mbrojtjen e biodiversitetit”

Ligji Nr.9774, date 12/07/2007 "Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis"

Ligji Nr. 162/2014 “Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis”

Ligji Nr. 10081, date 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", ndryshuar me ligjin nr.10.137, date 11.05.2009.

Ligji Nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”

Vendime te Keshillit te Ministrave (VKM)

VKM Nr.268, date 24.04.2003 "Per certifikimin e specialisteve, per vleresimin e ndikimit ne mjedis dhe te auditimit mjedisor."

VKM Nr.24, date 22.01.2004 "Per veprimtarine e inspektoriatit te mjedisit"

VKM Nr.177, date 31.03.2005 "Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret”

VKM Nr.686, date 29.7.2015 per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (vnm) dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore.

VKM Nr.99, date 18.2.2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve”

VKM Nr.267, date 7.5.2014 “Per miratimin e listes se substancave prioritare ne mjediset ujore”

VKM Nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”

VKM Nr.229, date 23.04.2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe informacionit qe duhet te perfshihet ne dokumentin e transferimit.”

VKM Nr.803, date 4.12.2003 “Per miratimin e normave te cilesise se ajrit”

3.3 Kuadri Ligjor European

Raporti i VNM-se per projektin ne fjalë, merr ne konsideratë dhe mundohet të përjashtë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit ne fushën e politikës së ujrave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.

- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshilit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
 - Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
 - Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
 - Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojava te Planeve dhe Programeve te Caktuara mbi Mjedisin.
 - Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojava të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
 - Direktiva e Këshilit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
 - Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e urjave te embla Direktiva 99/61/CE per gropat e mbetjeve
Direktiva 91/689/CE per mbetjet e rrezikshme

4. PERSHKRIMI I MJEDISIT EKZISTUES

4.1 Terreni, peisazhi dhe trashëgimia kulturore

Nga harta e shfrytëzimit të pronës tregohet përberja e përgjithshme e habitateve natyrore dhe veprave të bera nga njeriu si dhe veprimtaritë e tjera që lidhen me zonën. Nuk ka objekte të trashëgimisë kulturore në zonën e projektit dhe as në afërsi të saj.

4.2 Karakteristikat klimatike të Tiranës

	Emertimi	Vendmatja Tiranë
1	Temperatura mesatare vjetore, °C	15.1
2	Temperatura mesatare më e lartë në verë, °C	29.9
3	Temperatura më e lartë absolute, °C	42.2
4	Temperatura mesatare më e ulët në dimër, °C	6.7
5	Temperatura më e ulët absolute, °C	-10.4
6	Reshjet mesatare vjetore, mm	1270
7	Reshjet maksimale vjetore, mm	1770
8	Reshjet minimale vjetore, mm	773
9	Avullimi mesatar (E.T.P); (E.V), mm	880; 600
10	Drejtimi mbizotërues i erës vjetore	N; Ë (14.6%)
11	Mbizotërimi i drejtimit të erës në verë	N: Ë (2- -5%)
12	Mbizotërimi i drejtimit të erës në dimër	S.E. (17- -5%)
13	Shpejtësia mesatare e erës, m/sek	1.8

14	Presioni bazë i erës, kg/m ²	0.281
15	Thellësia maksimale e borës, cm	15
16	Thellësia maksimale e ngrirjes së tokës në cm	10
17	Lagështia relative mesatare vjetore, %	70
18	Lagështia relative mesatare në verë, %	63
19	Lagështia relative mesatare në dimër, %	73
20	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 0.1 mm	129
21	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 1 mm	100
22	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 5 mm	64
23	Numri mesatar i ditëve me reshje ≥ 10 mm	45
24	Zgjatja faktike e diellzimit në orë, vjetore	2530
25	Magnituda maksimale e pritshme	60-70


4.2.1 Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit është një nga elementet kryesor klimatik që shërben për të karakterizuar klimën e një vendi apo një rajoni. Me regjimin mesatar, me ecurinë e saj vjetore e ditore si dhe me vlerat ekstreme, ndikon në strukturat ndërtimore.

Paraprakisht duhet vënë në dukje se gjithë Ultësira Bregdetare (ku ndodhet zona në studim) gjendet nën ndikimin e fuqishëm të detit Adriatik.

Një nga parametrat më të rëndësishëm të temperaturës së ajrit është temperatura mesatare e tij. Për të studiuar shpërndarjen e këtij elementi në zonën në studim si dhe shpërndarjen e tij gjatë vitit, në tabelën e mëposhtme jepen temperaturat mesatare të vendmatjes meteorologjike Tiranë.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
Mes													
Tiranë	6.9	7.9	9.9	13.3	17.7	21.6	23.8	23.8	20.6	16.1	11.8	8.2	15.1



Të dhënat e mësipërme paraqiten dhe në formë grafike në figurën e mesiperme. Përsa i përket luhatjes brenda vitit të temperaturës së ajrit duhet thënë se kemi të bëjmë me një regjim tipik ku temperatura minimale vërohet në muajin Janar, 6.9°C, ndërsa temperatura maksimale vërohet në muajt Korrik dhe Gusht 23.8°C.

Një parametër tjetër i rëndësishëm i temperaturës së ajrit është edhe temperatura ekstreme e tij (minimale dhe maksimale). Për temperaturat minimale është bërë një analizë më e detajuar për vetë kushtet që kërkohen kur bëhet një projekt për rrugën automobilistike.

Kështu janë llogaritur ditët me temperaturë negative (të ashtuquajtura ditë të ftoha) për vendmatjen meteorologjike Tiranë. Për objektin që po studiojmë në zonën tonë, rëndësi paraqesin gjithashtu edhe numri i ditëve me temperature nën -10°C, që quhen ditë të akullta. Në zonën në të cilën shtrihet objekti në studim, temperaturat nën -10°C janë tepër të rralla.

Në përfundim, përsa i përket temperaturave të ajrit duhet thënë se zona në studim karakterizohet nga një klimë e butë mesdhetare.

4.2.2 Mjegulla

Mjegulla është ngjarje atmosferike që vështirëson transportin rrugor, detar dhe ajror sidomos kur ka intensitet të madh. Paraprakisht, duhet thënë se mjegulla si fenomen atmosferik është dukuri e rrallë në Shqipëri. Për pasojë edhe zona në studim preket shumë pak nga kjo dukuri.

Për të analizuar mjegullën do të ndalemi në dy aspekte, në numrin e ditëve me mjegull dhe kohëzgjatjen e saj në orë. Të dhënat mbi mjegullën jepen në tabelën e mëposhtme.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes
Tiranë	2.5	2.0	0.7	0.2	0.7	0.1	0.0	0.1	0.4	0.5	1.5	1.6	10.5

Nga tabela e mesiperme rezulton se mesatarja vjetore më e madhe është 10.5 ditë me mjegull në Tiranë. Në përgjithësi në muajt e stinës së verës në vendmatjen meteorologjike të vendit tonë, mjegulla është një dukuri e rrallë. Nga analizat e materialit të ngjarjeve atmosferike të elementit mjegull për të cilët jepet


numri i ditëve me mjegull, u llogarit edhe koha e zgjatjes së mjegullës. Rezulton se në të gjithë zonën në studim mjegulla zhvillohet pas mesit të natës, rreth orës 2 ose 3 dhe vazhdon deri në orën 9-10 të mëngjesit. Por nuk përjashtohen rastet kur mjegulla zhvillohet në orët e mbrëmjes. Si rregull, në muajt e periudhës së ngrohtë të vitit, mjegulla zhvillohet rrallë dhe në qoftë se ka raste që zhvillohet nuk zgjat shumë kohë, p.sh. në Tiranë kohëzgjatje mesatare e mjegullës është 2 orë e 24 minuta. Kohëzgjatja maksimale pa ndërprerje e mjegullës në Tiranë është realizuar më 29 dhe 30 Janar 1968 për 11 orë e 43 minuta.

4.2.3 Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë nga elementët më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të një zone. Në rastin e projektimit, veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e sistemit të drenazhimit që lidhet direkt me mirëmbajtjen e rrugës dhe nga ana tjetër lidhet edhe me kushtet e transportit të mjeteve lëvizëse. Faktorët që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve atmosferike janë në pozicionin gjeografik, afërsia me detin dhe orografia. Objekti që po studiojmë shtrihet në pjesën Veri- Perëndimore të vendit, në Ultësirën bregdetare pranë detit Adriatik me një relief të ulët fushor dhe kodra që e rrethojnë nga perëndimi dhe e mbrojnë nga erërat bregdetare. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat mbi reshjet mujore dhe vjetore.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Tirane	135	126	113	102	92	63	38	45	84	111	162	141	1210

Konkretisht në zonën në studim, sasia e reshjeve vjetore është rreth 1200 mm. Sasia më e madhe e reshjeve ku janë regjistruar 1770mm dhe më e vogla 770 mm në vit. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit Shqiptar (1400mm), kjo zonë është më e ulët në sasinë e reshjeve atmosferike. Siç tregohet në ilustrimin Nr.2 shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka një formë “U” që është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve pritet gjatë periudhës së ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë Nëntor-Dhjetor (162 dhe 141 mm përkatësisht). Muaji më i thatë është Korriku (38 mm).



Për objektin që do të përcaktojmë, përveç reshjeve mujore e vjetore, rëndësi paraqesin edhe shpeshësia e shfaqjes së reshjeve të vogla si: 0.1 mm, 1.0 mm, 5 mm dhe 10 mm. Për këtë qëllim janë llogaritur për

gjithë periudhën me të dhëna për vendmatjen meteorologjike Tiranë numri i ditëve me reshje ≥ 0.1 mm, ≥ 1.0 mm, ≥ 5 mm dhe ≥ 10 mm . Ne tabelen e mëposhtme jepen karakteristikat kryesore të reshjeve.

Vendmatja	Numri i ditëve			
	Reshje ≥ 0.1 mm	Reshje ≥ 1 mm	Reshje ≥ 5 mm	Reshje ≥ 10 mm
Tirane	129	100	64	45

Reshjet intensive në sasi të mëdha për intervale të ndryshme kohëzgjatje dhe sidomos për kohëzgjatjet e mëdha, vrojtohen situata të caktuara sinoptike dhe sidomos ku ciklonet dhe frontet atmosferike janë stacionar. Ato gjithashtu janë të lidhura me llojin e reve dhe të ndikimeve lokale. Duke pasur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudha të ndryshme kthimi (return periods) zona në studim karakterizohet për intensitete të lartë të reshjeve. Në vendmatjen meteorologjike Tiranë brenda 24 orëve kanë rënë 237.4 mm.

Si ndryshim i ndryshueshmërisë së madhe në kohë dhe hapësirë të reshjeve maksimale 24 orëshe, e domosdoshme është edhe se çfarë sasi reshjesh janë të mundshme gjatë 24 orëve në zonën në studim dhe sa shpesh përsëriten ato. Për këtë qëllim u llogaritën reshjet maksimale për periudha përsëritje të ndryshme.

Përveç reshjeve 24 orëshe me interes do të ishte njohja e intensiteteve të reshjeve me intervale kohe të shkurtër dhe paraqitja e tyre me probabilitet të ndryshme të paraqitura me probabilitet të ndryshme të paraqitura më lartë, ku theksojmë se llogaritjet janë bërë për vendmatjen meteorologjike Tiranë që ka pasur aparat vetëregjistruar (pluviograf) dhe rezultatet e llogaritjeve janë paraqitur në figurën 3 ku janë paraqitur të ashtuquajtura kurbat intensitet- kohëzgjatje- probabilitet.

4.2.4 Bora

Në vendin tonë, në periudhën e ftohtë të vitit, një sasi e konsiderueshme e reshjeve vjen prej borës. Kjo veçori është më e theksuar në zonën malore ku bora është një dukuri e zakonshme. Në zonën në studim bora vrojtohet rrallë dhe mund të konsiderohet si dukuri e jashtëzakonshme. Numri më i madh i ditëve me borë në zonën në studim është rreth 3 ditë në vit.

Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme rezulton se muaji Janar ka numrin më të madh të ditëve me borë, duke u ndjekur nga Shkurti dhe Dhjetori.

Ne tabelen e mëposhtme paraqitet numri mesatar i ditëve me bore.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma vejtore
Tirane	1,3	0,9	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,3	1,3

Në zonën në studim, për shkak të ndikimit zbutës të detit nuk ka kushte të përshtatshme për krijimin e shtresës së borës. Ajo krijohet rrallë, por edhe kur krijohet, nuk mund të qëndrojë gjatë. Bora krijon shtresë dhe mund të qëndrojë gjatë vetëm në dimra të jashtëzakonshëm të shoqëruar me temperatura negative të ulëta të vazhdueshme siç kanë qenë rastet e vitit 1949 ku bora arriti lartësinë 40cm dhe qëndroi disa ditë, Dhjetori i 1957 dhe Janari 1985. Mund të përmendim edhe vitet 1954-1955, 1960 dhe 1965. Lartësia mesatare maksimale e shtresës së borës në Tiranë arrin 8cm.

4.2.5 Lagështia e ajrit

Si një tregues i rëndësishëm i lagështirës së ajrit shërben lagështia relative e ajrit e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin njerëzor. Në ecurinë vjetore të këtij treguesi vërehen ndryshime që janë kushtëzuara nga qarkullimi stinor dhe relievi. Të dhënat e tabelës se mëposhtme tregojnë se vlerat më të larta të lagështirës relative të ajrit vrojtohen në gjysmën e ftohtë të vitit, gjë që shpjegohet me veprimtarinë ciklonare që vrojtohet në zonën e marrë në studim gjatë kësaj periudhe të vitit. Vlerat më të larta i takojnë muajve Nëntor, Dhjetor dhe Janar. Ndërkaq vlerat më të ulëta ë lagështirës relative vrojtohen në muajin Korrik dhe Gusht, pikërisht kur mbi rajonet e Mesdheut vërehet një qëndrueshmëria anti-ciklonare e theksuar. Ecuria ditore e lagështirës relative është e kundërt me atë të temperaturës së ajrit. Në orët e para të mëngjesit realizohen vlerat më të larta kurse në orët e mesditës (para ose pas mesditës) vlerat më të ulëta.

Në zonën në studim mbizotëron forma qarkullimit perëndimor i cili duke u çvendosur nga perëndimi në lindje, sjell me vete masa ajrore të pasura me lagështirë dhe relativisht të ngrohta. Gjithashtu rritja e sasisë së reshjeve nga fundi i vjeshtës dhe fillimi i pranverës bën që lagështia relative gjatë vitit të qëndrojë në vlera pothuajse të përafërta.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e lagështirës relative gjatë vitit.

Vend matja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Mes. vjetore	Aplituda
Tirane	73	71	71	72	71	66	61	64	70	72	76	76	70	15

Për këtë arsye, zona në studim ka vlerë relativisht të lartë të lagështirës është relative dhe me ndryshime jo shumë të ndjeshme nga muaji në muaj më tjetrin. Amplituda vjetore midis vlerës më të lartë 76% dhe asaj më të ulët 61% është 15%. Lagështia mesatare vjetore është 70%

4.2.6 Era

Gjatë projektimit të rrugëve automobilistike dhe autostradave, një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe vlerësimi i karakteristikave të erërave në zonën në studim. Në parametrat kryesor të erës përfshihen edhe të dhënat për drejtimin e saj (shpeshtësia sipas drejtimeve të ndryshme) si dhe shpejtësia e saj sipas drejtimeve të ndryshme.

Ne tabelen e mëposhtme paraqitet Rastisja mesatare shumëvjeçare e drejtimit të erës dhe shpejtësia mesatare sipas drejtimeve.

Vendmatja	N		NE.		E		SE.		S		SË.		Ë		NË.		
	Q	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh	r	sh
Tirane	4	3.5	2,7	2,8	2,0	3,4	1,5	15,8	2,8	4,4	2,4	7,4	2,7	3,9	2,5	15.1	2.9

r- rastisje sh- shpejtësia m/sek

Vendmatja meteorologjike Tiranë karakterizohet nga një vlerë 44% e gjithë vitit me qetësi (nuk ka erë 44% e periudhës vjetore). Shpejtësia mesatare varion nga 2.9 m/sek në 1.5 m/s ndërsa ajo maksimale arrin në raste të veçanta atmosferike (tufane) deri në 40 m/s. Rastisjen më të madhe e ka drejtimi i erës (SE) Jug-lindje me rastisje në përqindje 15.8, dhe (NË) jug-perëndimi me 15.1%.

Përsa i përket shpejtësive mesatare vjetore të erës ato luhaten rrotull 1.5 m/s. Ne tabelen e mëposhtme paraqiten shpejtësitë mesatare të erës m/s.

Muajt													Mes.vj etore	Stinët			
														D	P	V	Vj
Tiranë	1	1.	1.	1.	1.	1.	1.	1.	1.	1.	1.	1.	1.5	1.	1.	1.	1.

Në vartësi të lëvizjeve të sistemeve barike dhe orografisë së zonës që studiojmë, era pëson ndryshime të rëndësishme. Të dhënat e deritanishme për shpejtësinë e erës përcaktojnë dhe karakteristikat e veçanta lidhur me forcën e saj.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat e rastisjes së erës në përqindje.

Vendmatja	Shpejtësi	Shpejtësi	Shpejtësi	Shpejtësi	Shpejtësi
Tiranë	59.7	36.1	4.0	0.2	0.1

4.2.7 Stuhitë

Stuhitë që për vendin tonë janë të shumta dhe ndodhin në të gjithë stinët e vitit, shpesh shoqërohen me breshër. Më shumë ditë me breshër ka në muajt e dimrit dhe gjysmën e vjeshtës dhe në gjysmën e parë të pranverës. Numri më i madh i ditëve me breshër vrojtohet në rrethin e Tiranës dhe Kamëz. Tirana gjatë viti ka 8 ditë me breshëri. Në Tiranë më 14 Maj 1963 gjatë 40 minuta breshëri, është formuar një shtresë disa cm e lartë.

Ne tabelen e mëposhtme paraqitet numri mesatar i ditëve me breshër.

Muajt	J.	Sh.	M.	P.	M.	Q.	K.	G.	Sh.	T	N.	Dh.	Shuma
Tiranë	1.1	1.3	0.9	1.3	0.6	0.3	0.1	0.1	0.2	0.3	0.9	1.0	8

Si rregull, zgjatja e breshërit është 3 deri 5 minuta. Në zonën në studim, breshëri vrojtohet në çdo kohë të vitit por më shumë në periudhën e ftohtë të vitit. Gjatë muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht një ditë me breshër. Ne periudhën e ngrohtë të vitit numri i ditëve me breshër është i pakët.

Stuhitë në zonën në studim mund të ndodhin në çdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar që ka klima e zonës tonë. Në thellësi të territorit të Gadishullit Ballkanik gjatë periudhës së ftohtë të vitit (dimrit) stuhitë pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental të klimës më atë rajon.

Ne tabelen e mëposhtme paraqitet Numri mesatar i ditëve me stuhi.

Vendmatja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma vjet.
Tiranë	1.8	1.9	1.5	2.6	4.1	2.7	2.8	2.1	2.2	2.8	3.4	2.4	30.3

Nga analiza e tabelës se mesiperme rezulton se me më shumë ditë në zonën në studim (Tiranë) ka 30.3 ditë në vit. Numri më i madh i ditëve me stuhi është në Maj me 4.1 ditë.

Shkaku kryesor që maksimumi i ditëve me stuhi vrojtohet në muajin Maj duhet kërkuar në qarkullimin e masave ajrore dhe në rastin e cikloneve.

Muaji Maj përfshihet në periudhën kur qarkullimi dimëror i atmosferës zëvendësohet me qarkullimin veror të atmosferës me ardhjen e masave ajrore nga deti për në thellësi të territorit të vendit tonë.



4.2.8 Llogaritjet Hidrologjike

Ne llogaritjet hidrologjike te nevojshme qe realizohen gjate projektimit eshte vlersimi i sasise se rreshjeve permes metodave statistikore, me qellim vlersimin e transformimit ne rrjedhe siperfaqsores te cilat me pas kanalizohen nepermjet rrjetit te drenazhit urban. Llogaritja e prurjeve te gjeneruara nga rreshjet atmosferike eshte nje element i cili kushtezohet nga shume faktore. Aspektet te cilat do te duhet te vlersohen gjate projektimit te nje sistemi drenazhi urban variojne nga ato urbanistike ne hidraulike dhe ambjentale etj.

Matja e sasise se rreshjeve permes rrjetit te pluviografeve publikohet nga IGJEUM (ish-Instituti i Hidrometeorologjise)

Ne botimin e vitit 1983 ‘‘Shirat Maksimale Vjetore te regjistruara ne Shqiperi sipas Stacioneve Meteorologjike’’ realizuar nga Universiteti I Tiranes, Fakulteti I Inxhinierise, jane pasqyruar rreshjet

maksimale per qytetin e Tiranës me kohezgjatje 10,20 dhe 30 minuta si dhe 1,2,6,12,24,48,72 ore nga viti 1953-1976:



Ne forme tabelare te dhenat permbliiden si me poshte

Viti	10'	20'	30'	Iore	2ore
1950	10.4	20.5	30.9	44.9	48.8
1951	16.8	20.7	23.4	27.3	34.4
1952	4.7	8.5	11.1	16.7	18.6
1953	11.5	12.2	18	26.8	29.9
1954	24.3	28.5	29.2	30	30
1955	16.3	22.6	26.5	33.2	37.7
1956	11.4	16	18.5	20.5	30.7
1957	15.8	16.4	21.7	33	48.5
1958	15	22	22.6	31.2	50.1
1959	10.8	15.5	17.8	22.3	25
1960	12.2	12.5	15.3	20.6	21.4
1961	17	19.8	20.1	31.8	31.8
1962	13.3	16.4	27.3	40	50.4
1963	13.4	19.8	25.6	27.2	56
1964	15.9	25.4	30.9	40.5	59.9
1965	5.8	8.2	10.5	13.8	15.7
1966	16.1	19.4	23.7	31.1	37.2

1967	12.8	20.1	28	40.8	57.4
1968	22	31.7	31.7	34.5	59.3
1969	11.9	17.3	25	30.6	34.5
1970	17	24.9	25.9	27.1	34.6
1971	11	19.9	28.1	38.7	57
1972	17.9	25.5	34.2	48.5	60.4
1973	13.9	19.6	19.8	24.5	32.6
1974	13.2	22.1	23.5	24.6	32.7
1975	22.7	25.3	26.2	27.1	31
1976	17.5	23.8	26.6	33.8	57.5

Te dhenat e rreshjeve na lejon qe te kryejme perpunimet e nevojshme ne menyre qe te percaktojme te ashtuquajturen *rreshje llogaritese*.

5. CILËSIA E AJRIT DHE ZHURMAT

5.1 Cilësia e ajrit

Megjithëse nuk ka monitorime për cilësinë e ajrit, mund të themi se në përgjithësi cilësia e ajrit është e mirë. I vetmi burim i ndotjes së ajrit këtu mund të jete procesi germimit të kanalit. Gjatë aktivitetit të ndertimit do të ketë emetime pluhurash, që kryesisht kanë në përmbajtje grimca të argjilore . Duke pasur parasysh vendodhjen dhe terrenin ndikimi do të jetë i pa konsiderueshëm.

5.2 Ndotja akustike

Zhurmat në kushtet aktuale nuk përbëjnë ndonjë shqetësim. Krijuesit më të mëdhenj të zhurmave janë mjetet e germimit dhe transportit Matje për nivelin e këtyre zhurmave deri tani ,tregojne se niveli i tyre eshte shume i ulet.

5.3 Rrjeti ujqor

Në vendndodhjen e objektit kemi burime të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore që të ndikohen nga aktiviteti i ndertimit. Rrëketë që formohen në rast reshjesh janë lehtësisht të komandueshme pasi nuk janë me prurje të lartë,.

Aktiviteti i ndertimit ndikohet nga rrjeti hidrografik i zonës. Nuk kemi përdorime të veçanta të ujit për teknologji.

5.4 Biodiversiteti

Per kushtet klimatike dhe pozicionin gjeografik ku gjendet zona e studimit eshte shume e pasur me shumellojshmeri faune dhe flore. Me poshte japim nje prezantim te shkurter te tyre.

5.5 Flora dhe fauna

a.Ekosistemet, habitatet

Fshati i Gerblleshit ndodhet ne influencat e mikrobaseneve lumore (Erzeni); përmban disa ekosisteme të cilët janë ekologjikisht të ndryshëm, të rëndësishëm për habitate karakteristike dhe asocimet e tyre. Vlera ekologjike të këtyre zonave është një burim natyror për banoret dhe i rëndësishëm për një hapsirë rurale.

5.6 Përdorimi i biodiversitetit

Elementët që lidhen me biodiversitetin nuk janë përdorur në mënyrë të planifikuar ose për qëllime të veçanta nga subjekte të ndryshëm, përjashtuar përdorimin e lëndes drusore dhe grumbullimi i bimve mjeksore.

Gjuetia spontane si dhe përdorimi i drurëve dhe shkurreve për ngrohje sidomos pas viteve 1990 kanë dhënë ndikimin e vet në dobësimin e vegjetacionit.

5.7 Trashëgimia arkitektonike dhe historike, zonat arkeologjike

Zona ku ndodhet objekti nuk dallohet për objekte të veçanta arkitekturore e historike si dhe gjetje arkeologjike. Sipas studimit gjeologjik karakteristikat gjeomorfologjike e arkitektonike janë të zakonshme, e deri sot nuk përfaqësojnë ndonjë objekt të veçantë për t'u marrë në mbrojtje ligjore.

6.TË DHËNA MBI IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË HAPJES DHE SHFRYTËZIMIT TË OBJEKTIT

6.1 Ndikimet në florë dhe faunë

Siç e theksuam edhe më sipër, flora dhe fauna në zonën e ndërtimit objektit është e pasur me shkurre dhe peme. Megjithatë duhet pranur se ndikimet në florën barishtore në afersi të sheshit të ndërtimit janë për tu marrë në konsideratë.

Ndikimet në faunë do të jenë më të pakta. Klasat që do të ndikohen më shumë do të jenë ato të të zvarranikeve, peshqit dhe shpendët, por speciet që do të preken janë të parëndësishme dhe nuk figurojnë ndër ato të rrezikuara, endemike, të mbrojtura apo të kërcnuara.

Nuk do të ketë ndikime në fragmentimin e habitateve. Pra projekti nuk nxitë uljen e kapaciteteve të specieve për riprodhim apo të ketë rreziqe për degjenerimin e popullatës.

Në këtë zonë nuk ka lloje bimore që mbrohet me status të veçantë. Flora dhe fauna lokale nuk do të ndikohet nga shfrytëzimi.

Mast rehabilituese të sheshit do të mundësojnë përmirësimin e gjendjes së florës e faunës si dhe të biodiversitetit në përgjithësi. Gjithashtu do të mundësohet edhe përmirësimi i pejsazhit dhe i mjedisit përreth. Në rehabilitimin e shpejtë kontribuon edhe vetë natyra e specieve që preken, të cilat janë të Ndotja akustike (zhurmat)

Zhurmat që krijohen gjatë punës, mjetet e germimit dhe transportit do të jenë në kufijë të lejueshëm, jo më të larta se 40 Db. Zhurmat nuk do të kenë vijushmëri, por do të jenë me ndërprerje në kohë. Keto jane me te theksuara gjate dites , ndersa gjate nates punimet nderpriten.

Zhurma e makinerive ne distance 7 m nga to, është 40 dB. Duke marrë parasysh shprehjen e nivelit të intensitetit akustik të një zhurme me relacionin e më poshtëm:

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

L - Niveli akustik i zhurmës të marrë në konsideratë .

I_1 --Intensiteti akustik i zhurmave të kumuluar

I_0 - Intensiteti akustik i references

Vlerësojme se niveli akustik i zhurmës është më i ulët se ai i zhurmës së një makine që kalon në të, praktikisht ai është 40-50 dB që i përgjigjet kushteve të një bisede me zë normal.

Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga makineritë dhe pajisjet që do të perdoren në objekt , tregon se ato ndodhen nën mesataren e frekuencës 200-2000Hz, e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut.

6.2 Pluhurat gjatë procesit të punës

Emetimi i pluhurave në ajër, është në nivele shumë të ulata dhe i perkoheshem. Për punonjësit që punojnë në objekt apo edhe pranë tij do të merren masa mbrojtëse duke i pajisur me maska me filtra mbrojtës për sigurinë e shëndetit. Gjithashtu do të respektohen rregullat dhe rregullorja e Sigurimit Teknik në punë.

Produktet e djegies së karburantit të automjeteve apo apo te mjeteve te ngarkim shkarkimit qe burimin e energjise e kan me motorra diezel do të jenë në parametra normal dhe nuk do të krijojnë ndonjë problem të veçantë mjedisor.

6.3 Ndikim në shëndetin e njerëzve që punojnë në objekt dhe të banorëve për rreth.

Kontraktori do të ketë një plan për trajnimim e fuqisë punëtore. Kjo do të aplikohet për të gjithë punëtorët përpara fillimit të punës.

Punonjësit, që do të jenë prezent në punë do të jenë të mbrojtur nga mjetet personale mbrojtëse kundra pluhurit dhe zhurmave të cilat do të jenë të kufizuara vetëm brenda zonës së shfrytëzimit.

Duke u nisur nga largësia e zonës së banuar, si dhe me marrjen e masave të sigurisë në punë nuk do të ketë dhe nuk priten ndikime në shëndetin e popullsisë së zonës dhe punonjësve të saj.

6.4 Rreziqet e aksidenteve

Aktiviteti për ndërtim montimin e ketij objekti shoqërohet edhe me aspekte që paraqesin rrezikshmëri në drejtim të punës me makineritë, si eskavator , automjete , fadroma etje, si dhe për shkak të mos respektimit të normave teknike të Rregulloreve përkatëse të Teknikës së Sigurimit etj. Për këtë qëllim projekti i ndërtim-montimit është ndaluar në të gjithë elementët që paraqesin rrezikshmëri.

Projekti i shfrytëzimit dhe ndërtimit e tij është mbështetur në Rregulloren e Sigurimit Teknik dhe mbrojtjen në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të lëshuara nga dikasteret përkatëse.

Për veçoritë e punës, përcaktohen rregullat e sigurimit teknik në punën me makineritë, rrymën elektrike, shkarkesat atmosferike etj. Projekti përcakton si detyrë ligjore për investitorin, veç të tjerave, vendosjen në vende të dukëshme edhe natën të reklamave me pjesë të rregulloreve të sigurimit teknik. Sigurimin e kushteve normale të punës dhe mjeteve mbrojtëse.

Në të gjitha rastet do të punësohen puntorë me eksperiencë pune në këtë lloj veprimtarie.

Drejtuuesi teknik i punimeve, para fillimit të punës dhe gjatë saj, do të zbatojë rregullat dhe normat e përcaktuara në:

Rregulloren e Teknikës së Sigurimit për operacionet e punës që do të kryhen gjatë ushtrimit të aktivitetit dhe të gjitha detyrimet e tjera që kanë të bëjnë me sguirinë teknike dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve.

Detyrimet e punëdhënësit:

Punëdhënësi vetë ose nëpërmjet drejtuesit teknik që ka të punësuar, duhet t’u bëjë të ditur punëmarrësve:

- Procesin teknologjik të operacioneve në tërësi dhe të punës në frontin ku punon.
- Paisjet dhe makineritë që përdoren.
- Shkaqet e aksidenteve dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e Teknikës së Sigurimit dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, të lëshuara nga intitucionet përkatëse.
- Veçoritë e punës për secilin operacion ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë për mënjanimin e aksidenteve sidomos në kushte lagështie dhe rreshjesh, për mbrojtjen e makinerive dhe të punonjësve.
- Rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës, makineritë dhe profesionin që kryen punëmarrësi, për mbrojtjen e vetes dhe punonjësve të tjerë, të cilët kryejnë aktivitetet pune ose janë vizitore.

-
- Ndhimën e parë shëndetësore.
 - Vendosjen në teritorin e sheshit të ndertimit dhe në rrugën e hyrjes dhe të daljes së tij, në vende të dukshme shkrime të ndryshme me pjesët kryesore të rregulloreve të sigurimit teknik.
 - Të pajisen punonjësit me mjetet mbrojtëse, si doreza, maska, rroba pune, kapele etj.
 - Të kryejë instruktimin paraprak dhe periodik të punonjësve si dhe të plotësojë dokumentat sipas formularit të përcaktuar në rregulloren e Teknikës së Sigurimit.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njohë mirë procesin e punës që ka për të kryer.
- Të njohë mirë teknologjinë e përdorimit dhe shfrytëzimit të paisjeve dhe makinerive.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloret e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të publikuara nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punës.
- Të dije mirë shkaqet e mundëshme të aksidenteve në zbatimin e projektit, për çdo proces pune.
- Të sigurojë vehten dhe punonjësit e tjerë gjatë procesit të punës.
- Kur konstaton shenja të një avarie të mundëshme që është burim aksidenti, në radhe të parë, merr masa për eliminimin e saj, ndërkohë lajmëron gjithë punonjësit për rrezikun dhe ve në dijeni drejtuesin teknik të linjës.
- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.
- Të njohët sinjalistikën vertikale dhe horizontale për kahjet e lëvizjes së mjeteve, makinerive dhe njerëzve

1. Aspektet negative në mjedisin human

Pluhurat e krijuara gjatë ndertimit dhe aktivitetit normal të objektit, pavarësisht se janë në sasi të vogla, do të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve që punojnë aty. Për të ulur efektin negativ të tyre duhet detyrimisht të përdoren paisjet mbrojtëse si maska, doreza etj si dhe spërkatja me ujë në kushtet e thatësirës.

2. Aspektet pozitive të ndikimit në mjedisin human

Ndërtimi dhe vënia në funksion i objektit të me siperme do të ndikojë pozitivisht në nxitjen e punësimit. Ssiemimi dhe pemet e mbjella kanë një ndikim pozitiv në permiresimin e cilesise se ajrit në zone.

6.5 KUADRI LIGJOR I POLITIKAVE, PLANET Zonat e caktuara me ligj

Zona ku është objekti nuk klasifikohet dhe nuk përfshihet në asnjë zonë me status të veçantë mbrojtës për vlerat natyrore apo me objekte të rëndësishme historike e arkeologjike, arkitektonike, monumente natyrore etj.

Projekti i propozuar nuk ndikohet nga marrëveshje ndërkombëtare, konventa etj

7.MATRICAT E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ndikimet tek njerëzit, ndërtesat dhe objektet e ndërtuara nga njeriu

7.1 Ndryshimet në popullsi

Lloji i ndikimit ne popullsi	Identifikimi i ndikimit			
	Gjate operimit		Pas perfundimit	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndryshime në dendësinë e rritjes së popullsisë të zonës në shqyrtim	X		X	

Nuk do të ketë ndryshime në strukturën e popullsisë së zonës apo në ndërtim banesash të reja, pasi në këtë aktivitet numri i të punësuarve është kufizuar të cilët do të jenë nga kjo zonë.

Aktiviteti i është tillë që pastrimi dhe mbajja pastrimi e territorit të tij bëhet nga kompani të specializuara pastrimi të cilat pas përfundimit të punës kryejnë edhe ujitjen kryesore e cila ndikon pozitivisht në uljen e shkarkimit të pluhurave në ajër. Gjithashtu janë marrë masa, në zbatim të rregullores së sigurimit teknik në punë, që punëtorët të paise me maska filtruese, të cilat detyrimisht do të përdoren gjatë gjithë kohës së punës.

Kjo bën që të zbuten ndikimet negative në dobi të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve dhe kushtet e punës të jenë në parametra normal, konform specifikës së këtij aktiviteti.

Punëtorët që do të punojnë me mjete motorrike, si fadroma për ngarkim shkarkim, do të tregojnë kujdes në zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, për të parandaluar aksidentet në punë.

7.2 Ndikimet e dukëshme të projektit

Lloji i ndikimit në estetikën mjedisore	Identifikimi i ndikimit	
	Gjatë operimit	Pas përfundimit

	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Do të ketë ndonjë pengesë të pamjes së horizontit apo çfarëdo pamje publike		X		X
Do të ketë prishje të pozicionit ekzistues		X		X
Do të ketë prishje të terrenit të pa pranueshem estetikisht.		X		X

Gjatë kohës së ndertimit të objektit do ketë ndryshime të vogla të peisazhit që vijnë si rezultat i grumbujve të produktit inerteve të ndryshme, që do të depozitohet në shesh. Ndikimi i tyre në pejsazh nuk do të jetë i ndjeshëm.

LLOJI I NDIKIMIT NË TRASHËGIMINË KULTURORE	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndryshim apo dëmtim të zonave arkeologjike apo me vlera historike e kulturore.		X		X

Në këtë zonë nuk ekzistojnë objekte të tilla me vlera të veçanta arkitekturore dhe nuk do të ketë ndikime të tjera direkte ose indirekte mbi trashëgiminë kulturore etj.

LLOJI I NDIKIMIT NË ENERGJI	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Përdorimi i sasive të karburanteve për energji		X		X
Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime të energjisë apo kërkesa		X		X

për tipe të reja energjie					
---------------------------	--	--	--	--	--

Si burim i vetëm energjie për punën gjate ndertimit te objektit është energjia elektrike, ndërsa sasia e karburantit që shpenzojne eskavatore,fadromt apo mjete te tjera në procesin e germimit është e vogël, nga ana tjetër nuk mund të lindë nevoja për burime të tjera energjie.

Ndikimet në florën, faunën dhe gjeologjinë

7.3 Humbje e dëmtim habitati, specie bimore dhe tipareve gjeologjike

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATE OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Humbja e dëmtimi i habitateve dhe i specieve bimore e shtazore		X		X
Ndryshime në llojshmëri e numerin e çfardolloj kafshë,shpendi apo zvarraniku		X		X
Pengim në shtegëtimin e kafshëve		X		X
Pakësime të numerit të kafshëve të rralla dhe në zhdukje		X		X
Pakësimin e mjedisit fizik të kafshëve të gjuetisë.		X		X
Konseguenca të tjera ekologjike		X		X
Humbje e dëmtim të tipareve gjeologjike, paleontologjike dhe fiziografike		X		X

Nga ndertimi apo dhe venia në funksionim të këtij projekti nuk do të ketë ndikime negative në florën dhe faunën e zonës (me përjashtim të dëmtimit të florës barishtore në sheshin e ndertimi Duke u nisur edhe nga veçoritë e terrenit, nuk preket as edhe ndonjë koridor i veçantë ekologjik.

Ndikimi në tokë

7.4 Ndikimet fizike

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATE OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Humbje e tokave dhe kullotave	X			X
Erozionin e tokës		X		X
Pjesë si e pa stabilizuar		X		X
Prishje e tokës bujqësore		X		X
Kontaminim i tokës prej rrjedhjeve		X		X
Kontaminim i tokës nga depozitimi i llumrave.		X		X
Kontaminim i tokës nga rrjedhjet e ngurta.		X		X

Përjashtuar sipërfaqes së objektit, e cila është e miratuar si shesh ndertimi që me parë, nuk do të ketë humbje të kullotës në zonën për rreth pas zona nuk ka parceal që perdoren për kullote.

Nga vetë pozicioni dhe konfiguracioni i terrenit nuk pritet që të ketë erozion edhe në kohë me reshje maksimale.

Gjithashtu nuk do të ketë ndikime të papritura erozive, për arsye të aktivitetit. Kështu të gjitha punimet që mund të bëhen shkak për erozion, si gërmimet në thellësi apo punime të tjera të kësaj natyre janë krejtësisht të përjashtuara. Për këto nuk është parashikuar që të merren masa kundër erozionit.

Mbetjet në tokë, dherat: Sipas studimit, papastërtitë e materialeve te ndertimit (për vetë natyrën e objektit) janë pothuajse zero, pra nuk ka mbetje të tilla që të kërkojnë ndonjë administrim apo përpunim teknologjik të mëtejshëm, siç janë rastet e dampave të ndryshme.

Vibracionet e mjeteve motorrike nuk arrijnë në nivele të tilla që të përbëjnë ndonjë shqetësim të veçantë mjedisor. Ndikimi do të jetë në ngjeshjen e tokës gjatë lëvizjes së mjeteve brenda territorit të objektit dhe në segmentin nga objekti deri në lidhjen me rrugën nacionale. Por edhe ky ndikim nuk përbën ndonjë shqetësim të madh që të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis.

7.5 Ndikimet e emetimeve kimike dhe të depozitimeve

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Kontaminim i tokës prej rrjedhjeve		X		X
Kontaminim i tokës nga depozitimi i llumrave		X		X
Kontaminim i tokës nga rrjedhjet e ngurta		X		X
Emetime të ndryshme kimike		X		X
Depozitime të tjera.		X		X

Nuk do të ketë mbeturina të tjera e as llumra, pasi lënda e parë që përdoret nuk përmban papastërti dhe komponente të tjerë të dëmshëm, pra gjatë procesit te ndertimit nuk krijohen mbetje teknologjike të dëmshme.

7.6 Ndikimet në përdorimin e tokës

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATE OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ngritja e ritmit të përdorimit,		X		X

vlerësimi të çfardolloji degradimi fizik				
Dobësi të rëndësishme kudoqoftë në degradimet e rinovuara fizike.		X		X
Ndryshime të rëndësishme të programeve në të ardhmen e përdorimit të tokës.		X		X
Shkatërrim i banesave apo zonave të banuara		X		X
Shpronësim të tokës .		X		X

Vënia në shfrytëzim e këtij projekti nuk do të shkaktojë prishje të karakteristikave natyrore të gjendjes fillestare të mjedisi. Por duke qenë se nuk do të ketë prishje të karakteristikave natyrore të tokës rehabilitimi pas përfundimit të aktivitetit do të jetë më i lehtë. Pjesa e territorit ku zhvillohet aktiviteti, mund të rehabilitohet me mbjelljen e bimëve të përshtatëshme me kushtet natyrore të terrenit duke marrë masa të tjera kundër erozionit, duke zbutur kështu ndikimet që mund të ndodhin në peisazh gjatë periudhës së shfrytëzimit.

Aktiviteti nuk shoqërohet me tjetërsime e shpronësime të tokës.

Ndikimet në ujë

7.7 Ndikimet në modelin drenazhues, tipareve hidrografike etj

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndikimi i projektit në modelin e drenazhimit të tokës.		X		X
Ndryshime të nivelit të ujrave nëntokësore.		X		X

Ndikime në hidrologjinë bregdetare		X		X
Ndikimet e ndotësve, mbetjet në cilesinë e ujit..		X		X

Aktiviteti nuk ka të bëjë me shkarkime në ujë dhe me ndikime në rrjetin hidrogafik. Shpërlarjet nga reshjet e mineraleve të ndryshme nuk do të kenë ndonjë ndikim ndotës për arsye se pezullia nga grimcat e imta nuk është voluminoze dhe është e dekantueshme.

Ndikimet në ajër dhe në klimë

7.8 Niveli dhe përqëndrimi i emetimeve kimike etj

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Niveli dhe përqëndrimi i emetimeve kimike dhe efekteve të tyre mjedisore.		X		X
Lëndeve të veçanta.		X		X
Aromave sulmuese.		X		X
Ndikime të tjera klimatike.		X		X

Gjatë procesit të ndertimit ka emetime të vogla pluhurash me përmbajtje grimcash argjilore, ndikimi i të cilave është i pa konsiderueshëm. Nuk ka emetime të përbërësve kimikë, pasi ata nuk ekzistojnë.

Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare që shoqërojnë projektin

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Shtime të rëndësishme të lëvizjes së		X		X

automjeteve.				
Pakësim të vendqëndrimit të automjeteve apo nevoja për vendqëndrime të tjera.		X		X
Ndikim të rëndësishëm në sistemin ekzistues të komunikacionit.		X		X
Ndikime në mënyrën e përditëshme të qarkullimit apo të lëvizjes së njerëzve.		X		X

Transporti ndikohet në mënyrë të pa evitueshme vetëm nga lëvizja e mjeteve që transportojnë dherat. Por ky ndikim është shumë pak i ndjeshëm.

7.9 Ndikimet nga projekte të tjera

LLOJI I NDIKIMIT	IDENTIFIKIM I NDIKIMIT			
	GJATË OPERIMIT		PAS OPERIMIT	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Energjia elektrike.		X		X
Sistemi i telekomunikacionit.		X		X
Sistemi i ujësjellësit.		X		X
Sistemi i kanalizimit të ujrave të bardha dhe të zeza.		X		X
Mbetjet e ngurta e depozitimet e tyre.		X		X

Konsumi i energjisë elektrike nuk përbën ndonjë problem të veçantë si shpenzim energjie, si nga sasia ashtu edhe për faktin se kjo energji nuk lidhet me shpenzime burimesh natyrore të paripërritëshme. Aktiviteti nuk ndikon në sistemet e infrastrukturave të tjera si dhe nuk ka depozitime mbetjesh.

7.10 Ndikimet shoqëruese të projektit Përcaktimi i impakteve potenciale ambjentale

- **Impakte potenciale pozitive.**

Sistemim i bllokut me sistem ujitjeje është shumë i rëndësishëm për këto arsye kryesore:

- Permiroson gjelberimin në këto zone
- Permiroson peisazhin e zonës.
- Punësim modest të njerëzve.
- **Impakte potenciale negative.**
 - Largim i përkohëshëm i specieve të faunës nga vendi ku punohet, rritja e zhurmave nga mjetet e transportit dhe paisjeve të reja gjatë kohës së punës.
 - Emetimi i pluhurave me përmbajtje grimcash të argjilore gjatë kohës së ndërtimit.
 - Rritje të pranisë së gazrave si produkte të djegies së karburanteve nga mjetet motorrike gjatë ndërtimit.

Masa zbutëse

8. Masat për eliminimin ose zbutjen e ndikimeve në mjedis.

Programi i reabilitimit të zonës.

Programi është i fokusuar në zbatimin e kërkesave teknike, estetike e ekologjike të projektit të shfrytëzimit nga ku evidentojmë :

Masa teknike

- Respektim i kriterëve teknikë të organizimit të punimeve në ndërtim.
- Respektim i plotë i rregullores së sigurimit teknik, që lidhet me mënyrën e zgjidhjeve teknike të operacioneve të punës gjatë shfrytëzimit. Kjo lidhet me mundësinë më të mirë për reabilitimin korrekt në rast të mbylljes të aktivitetit.
- Trajnimi i punonjësve dhe marrja e masave të përgjithëshme për mbrojtjen e mjedisit.
- Transportimi i materialit dale gjatë gërmimit të bëhet me mjete transporti të destinuara për këtë qëllim dhe të mbuluara për shmangjen e derdhjeve aksidentale të materialit i cili ndot rrugët dhe mjedisin.
- Në rast të derdhjeve aksidentale të marrin masa të menjëhershme për eliminimin e pasojave dhe kthim në gjendje normale.

Masa estetike dhe ekologjike

- Zbatim koherent i masave që lidhen me shfrytëzimin, apo me ato të ruajtjes së parametrave teknikë e ligjorë, që kanë të bëjnë me ndikimet në ajër, ujë, shëndetin e njerëzve e të konfiguracionit adekuat të peisazhit dhe terrenit natyral.
- Mbjellje të drurëve pyjorë e dekorativë parashikuar dy anet e objektit.
- Krijimin e një ambjenti sa më estetik dhe funksional.

- Ruajtje dhe përmirësim të peisazhit.
- Kujdesi për punimet rehabilituese do të jetë i vazhdueshëm nga investitori i objektit

Programi i rehabilitimit

Rehabilitimi do të arrihet mbi bazën e monitorimeve të vazhdueshme, dhe vlerësimit të treguesve të dalë gjatë monitorimit të cilët do të na orjentojnë për marrjen e masave për ndikimet e ndodhura në mjedis. Kësisoj do të jetë më e lehtë për të përcaktuar masat zbutëse ndajë ndikimeve të ndodhura.

9. Planet e monitorimit

9.1 Plani i monitorimit të ndikimit në mjedis.

Nr	TREGUESIT QE DO TE MONITROHEN	Periudhat e arshivimit te dhenave e te raportimit ne ARM											
		J	Sh	M	P	M	Q	K	G	S h	T	N	Dh
	Te dhena mbi shfrytezimin e objektit.												
1	Numri i mjeteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2	Sasia e materiali te pa dobishem dhe administrimi i tij	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Problemet e erozionit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Treguesit estetik dhe ekologjik												
1	Realizimet e mbjelljes se fidanave sipas planit												
2	Situata ne lidhje me krijimin e habitateve te reja me vegjetacion												
3	Vezhgime mbi ndryshimin e												

	biodiversitetit												
	Treguesit qe lidhen me ndikimet ndotese												
1	Rastet e ndikimeve ne ndotjen e tokes nga shkarkime te ndryshme												
2	Te dhena mbi cilesine e ajrit, (NO2. pluhurat etj)												

Gjatë gjithë periudhës së ndertimit të rrespektohet kuadri ligjor për monitorimet dhe sipas rastit të specifikohen me detaje treguesit monitorimit.

Për kryerjen e monitorimit nga ana e investitorit duhet të meren të gjitha masat për ta bërë atë në vijueshmëri dhe rezultatet të mbahen në një regjistër të posaçëm.

Periodikisht subjekti duhet të raportojë pranë Agjensisë Rajonale të Mjedisit ne Tirane. Gjithashtu herë pas here duhet të komunikojë me grupet e interesit dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore dhe t'i informijë ato me rezultatet e monitorimit.

10. PËRFUNDIMET KRYESORE

- Aktiviteti do të ndikojë në zhvillimin dhe sistemimin e zones se fshaterave.
- Ndikimet në mjedis janë vlerësuar minimale dhe plotësisht të mundëshme për t'u mbajtur në parametra të lejueshëm ligjor sipas specifikës së projektit.
- Aktiviteti është i përcaktuar të jetë e duhet të jetë i angazhuar në forcimin e kapaciteteve të plota në menaxhimin e rehabilitimin mjedisorë të situatës që krijohet nga shfrytëzimi në përputhje me të gjitha satndartet aktuale ligjore e ato që do të vendosen në të ardhmen.

KONSULENTI:

"HTS COMPANY"sh.p.k & "MAGNA CHARTA" sh.p.k

ING. SAZAN GURI

